

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM, PËR PROGRAMIN E
STUDIMIT JOUNIVERSITAR, PROFESIONAL PAS
ARSIMIT TË MESËM, ME KOHË TË PLOTË
NË “MEKATRONIKË”
NË KOLEGJIN PROFESIONAL TË TIRANËS

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm: Dr. Ing. Thomaq KOBLARA
Dr. Alketa Grepcka



Shkurt/2018



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit profesional dy vjeçar në Mekatronikë

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Departamenti që e ofron	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara
3	Urdhëri/VKM i licencimit	Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 699, datë 26.08.2015 Leja e fillimit të aktivitetit: Urdhër i MAS, Nr. 426, datë 06.11.2015
4	Titulli i programit të studimit:	Program Studimi jouniversitar, profesional, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, në Mekatronikë
5	Cikli i studimit:	N/A Program studimi me karakter profesional
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
7	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	PO
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	5
15	Aktivizimi i programit të studimit	2016-2017
16	Numri total i studentëve për program studimi	15

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Kolegji profesional i Tiranës i njohur shkurt KPT është themeluar në datën 18/02/2015. Kolegji profesional i Tiranës është në pronësi të shoqërisë tregtare KPT sh.p.k. Shoqëria ka përgjegjësi të kufizuar. Themelimi i shoqërisë është bazuar në ligjet dhe legjislacionin e shtetit Shqipëtar për institucionet jo publike të arsimit të lartë. Shoqëria tregtare KPT sh.p.k. zotëron NIPT me numër rregjistrimi L51420003Q. Shoqëria është rregjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 21/02/2015. Rregjistrimi i shoqërisë tregtare KPT sh.p.k. është bërë me afat i pa përcaktuar. Bazuar në dokumentacionin e shoqërisë si dhe në verifikimin në vend të saj rezulton se adresa është: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi Xhura, Njësia Bashkiake Nr.4, zonë kadastrale 8130 me numër pasurie 5/200. Tiranë.

Liçensimi i shoqërisë KPT sh.p.k. është bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave me nr. 699 datë 26/06/2015 në ligjin "Për liçensimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional. Bazuar në dokumentacionin e ofruar rezulton se, liçensimi i "Kolegji Profesional i Tiranës" është botuar në fletoren zyrtare numër 154, datë 02/09/2015. Kolegji profesional ofron disa programe studimi jouniversitare, me karakter profesional të cilat ndiqen nga studentët të cilët kanë mbaruar arësimin e mesëm me kohë të plotë ose të pjesshme.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton se KPT sh.p.k. është pajisur me lejen e fillimit të aktivitetit në datën 06/11/2015 dhe urdhër të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit i cili mban numër 426 dhe datë 06/11/2015 për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë akademike në përputhje me liçensën e dhënë.

Kolegji Profesional i Tiranës ka ndërtuar kurrikulën mësimore për programin e studimit Mekatronikë. Programi i studimi ka vetëm dy vjet që është liçensuar dhe numri total i studentëve sot është 15, ku 6 studentë janë rregjistruar në vitin 2016-2017 dhe 9 studentë janë rregjistruar në vitin 2017-2018. Studentët e vitit të parë të rregjistrimit janë dhe studentët e parë të cilët do të diplomohen nga KPT për drejtimin "Mekatronikë" Programi i studimit "Mekatronikë" është në varësi të departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.

GRUPI I VLERESIMIT TE JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Dr. Ing. Thomaq KOBLARA
2. Dr. Alketa GREPCKA

Menaxhere teknike e ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure: Renata Qatipi (specialiste në ASCAL).

Më datë 16.01.2018 nëpërmjet sistemit AMS, KPT është njohur me Draft RVJ për këtë program studimi. Më datë 17.01.2018, me Nr. 28 Prot. "Dërgohen Draft Raportet e vlerësimit të jashtëm", është dërguar në KPT zyrtarisht Draft RVJ.

Kolegji Profesional i Tiranës sjell përgjigje me shkresë Nr. 199/4, datë 12.02.2018 "Përgjigje tuajës Nr. 28 prot, datë 17.01.2018 mbi Draft Raportet e Vlerësimit të jashtëm", duke u shprehur që është parimisht dakord me këtë Draft RVJ dhe duke kërkuar të bëhet një saktësim në faqen 10. Ekspertët e Vlerësimit të jashtëm pasi u njohën me shkresën, deklarojnë se janë dakord me sugjerimin dhe pranojnë ndryshimin në Raport, përkatësisht nga 350 orë mësimore në 360 orë mësimore (orë në auditor).

Pas saktësimit të sipërcituar në RVJ, ky Raport mori formën e tij përfundimtare

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin e kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Misioni i Kolegjit Profesional të Tiranës është të ofrojë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme që synojnë të ndihmojnë studentët të kenë sukses në gjetjen e mundësive të punësimit me një nivel të kënaqshëm të të ardhurave, ku kurset që ofrohen ndërtohen mbi parime praktike që u përgjigjen kërkesave të punëdhënësve dhe në mënyrë të tillë që ti përgatisin studentët dhe për studimet universitare. Misioni i KPT është zgjeruar më tej në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit 2015-2020 të institucionit. KPT synon të jetë një ndër ofruesit më të mëdhenj të arsimit profesional në vend. Një urrë lidhëse midis edukimit dhe trajnimit profesional.

Programi i studimit “Mekatronikë” ka si qëllim kryesor të përgatisë studentët me njohuri tekniko – aplikative, që kërkohen nga fusha të ndryshme të pajisjeve elektromekanike në industri, në ndërtesa, në banesa etj, të jenë të aftë për të punuar në fushat e automobilave, përpunimit të ushqimit, në përpunimin, paketimin, prodhimin e energjisë, minierave, problemeve, testimin, integrimin e sistemeve, mirëmbajtjen, programimin, automatizimin; si dhe të jenë të aftë për automatizimin industrial, robotikë, sistemet e kontrollit, përpunimit, hidraulikë, pneumatikë, sigurinë, kontrollorët e programueshëm logjikë (PLC) elektrikë, si dhe metodat e kompjuter-kontroll.

Programi i studimit jouniversitar, profesional pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në “Mekatronikë” është rezultat i ndërthurjes së programit të studimit të inxhinierisë mekanikë, elektrike dhe elektronike. Programi i studimit “Mekatronikë” pajis studentin me aftësi për tu specializuar brenda një kohe të shkurtër dhe në mënyrë autonome mbi bazën e kërkesave të tregut të punës. Programi i studimit Profesional Jouniversitar 2-vjeçar “Mekatronikë” ka për qëllim të hedhë bazat teknike dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si Teknikë të lartë në fushën e Mekatronikës.

Programi i studimit “Mekatronikë ” është të diplomojë specialistë të një niveli të ndërmjetëm cilët të kenë njohuri në fushën mekanike, elektrike dhe në fushën elektronikës së aplikuar. Themi specialistë të një niveli të ndërmjetëm sepse dhe pozicioni i tyre i punës do të zërë një vend të ndërmjetëm midis specialistit me kualifikim të lartë (inxhinierit mekatronik) dhe teknikut me kualifikim të mesëm. Programi i studimit “Mekatronikë” është mbështetur mbi nevojat dhe kërkesat e tregut për të pasur specialistë të cilët të kenë njohuri në këto tre fusha. Meqënëse industria e automobilave dhe linjat e automatizuara industriale janë bashkëveprim i proceseve (dukurive) mekanike dhe proceseve (dukurive) elektrike dhe elektronike kërkohet që personat të cilët do të shërbejnë për mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe pjesërisht riparimin e defekteve që mund të shfaqen gjatë rregjimit të punës të kenë njohuri në këto tre drejtime. Programi i studimit ka ofruar një grup lëndësh të cilat thellojnë njohuritë e studentit të fushën mekanike në fushën elektrike dhe atë elektronike.

Programi i studimi ka vetëm dy vjet që është licënuar dhe numri total i studentëve sot është 15, ku 6 studentë janë rregjistruar në vitin 2016-2017 dhe 9 studentë janë rregjistruar në vitin 2017-2018. Studentët e vitit të parë të rregjistrimit janë dhe studentët e parë të cilët do të diplomohen nga KPT për drejtimin “Mekatronikë” Programi i studimit “Mekatronikë” është në varësi të departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara.

Vizioni i programit “Mekatronike” është i inkorporuar në vizionin e KPT-së e cila shprehet qartë në Strategjinë e Zhvillimit të Kolegjit Profesional të Tiranës 2015 – 2020 [dok 7 fq 2]. Misioni i KPT-së shprehet qartë në

statutin e institucionit [dok 6, neni 6, pika 1]. Objektivat e KPT-se janë të shprehura qartë në Statutin e institucionit.

Departamenti ka pasur një staf prej 11 pedagogësh me kohë të plotë, të cilët për vitin akademik 2017-2018 janë 13. Në mbështetje të departamentit punojnë dhe një staf prej 13 pedagogësh të ftuar. Departamenti mbulon dhe programin studimor për degën “Elektro-Mekanikë”

Programi i studimit synon të zerë një vend të ndërmjetëm në kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Vendi që synon të zerë kurrikula qëndron midis specialistit me kualifikim të mesëm (profili mekatronik) dhe specialistit me kualifikim të lartë (inxhinierit mekatronik)

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi 1: Aftësitë specifike të lidhura me sektorin e punësimit janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë zhvillimit të programit të studimit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

- Kriteri 1** Punësimi është trajtuar në hartimin e kurrikulave, në karrierën arsimimin, informimin dhe udhëzimet.
- Kriteri 2** Punësimi është një çështje kyçe për miratimin e programit, monitorimin dhe rishikimin e tij.
- Kriteri 3** Studentëve i është dhënë mbështetje për zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit..
- Kriteri 4** Programi parashikon dhe kredite të përfituara gjatë punës
- Kriteri 5** Të përfshijnë inisiativa specifike si psh. mbështetje për sipërmarrjen
- Kriteri 6** Krijimi i lidhjeve punëdhënës / IAL.

Vlerësimi sipas standardit 1:

Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga grupi i vlerësimit të brendshëm si dhe nga pyetjet e zhvilluar nga GVJ rezulton se për hapjen e programit studimor “Mekatronikë” është realizuar një studim i tregut të punës si dhe kërkesat që kanë sipërmarrës të ndryshëm në lidhje me kualifikimin e personelit të tyre **[nga takimi me Rektorin, me stafin akademik, takim me studentët]**. Sipërmarrjet e ndryshme kërkojnë që personeli teknik të ketë njohuri si në fushën e shkencave mekanike, elektrike dhe elektronike. Ky personel duhet të jetë i aftë të diagnostifikojë defektet që lindin gjatë rregjimit të punës së makinerive industriale dhe automobilave. Në disa raste ai mund të ndërhyjë për t’i eliminuar ato në rast të kundërt të kërkojë ndihmën e personelit më të kualifikuar. Programi i studimit është mbështetur në ligjin e arsimit të lartë Nr. 80/2015.

Hartimi i programit mesimor është bere mbi bazën e eksperiences se shkollave profesionale ne Gjermani, Itali, Greqi dhe ne konsulence me Universitetin Politeknik te Tiranës. Programi është ndryshuar qe nga data e dorezimit te tyre ne Ministrine e Arsimit dhe te Shkences deri ne masen 20% por nuk është cenuar aspak permbajtja e lendes. Per hartimin e programit mesimor është studjuar edhe kërkesa e tregut ne Shqiperi ku nevoja per teknike te afte ne kete fushë është e madhe **[nga takimi me Rektorin, me stafin akademik]**.

Kolegji profesional i Tiranës ka lidhur kontrata me kompani dhe sipërmarrje të cilat kanë në përdorin makineri dhe sisteme elektro-mekanike në mënyrë që të sigurojë zhvillimi e praktikave profesionale. Kompanitë në funksion të vendeve të lira të punës, mundësojnë dhe punësimin e tyre. Meqënëse programi i studimit ka një histori të shkurtër (vetëm 2 vjeçare) që nga koha e licencimit si rezultat dhe numri i studentëve është shumë i vogël, prandaj nuk mund të flitet për një historik të punësimit të studentëve. Nga vizita në KPT rezulton se disa prej studentëve të cilët janë në vitin e dytë të studimeve sot janë punësuar me kohë të pjesëshmepranë kompanive të cilat kanë ofruar zhvillimin e praktikës profesionale. Bazuar në diskutimet e zhvilluara me pedagogët përgjegjës të kurrikulës rezulton se kanë për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të saj në funksion të kërkesave të tregut të punës.

Programi dy vjecar në “Mekatronikë” synon zhvillimin e aftësive në funksion të punësimit. Bazuar në diskutimin me studentët rezulton se atyre u jepet mbështetje e vazhdueshme për zhvillimin e aftësive në

funkcion të punësimit. Këtë e dëshmojnë dhe kontratat e lidhura me sipërmarrjet private për zhvillimin e praktikës profesionale.

Programi mësimor ka të integruar praktikën mësimore e cila vlerësohet me 10 kredite. Praktika mësimore zhvillohet në platformat industriale dhe pranë kompanive ose pikave të servisit të automobilave. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale studenti ka lirinë dhe mundësinë të implementojë njohuritë e tij për zgjidhjen e problemeve teknike, gjithmonë i kontrolluar nga personeli i kompanisë ku kryen dhe praktikën mësimore.

Programi mësimor ka karakter teknik dhe kërkon të specializojë studentët në fushën e specialistit. Nje fokus i veçantë i jepet pjesëmarrjes në orët laboratorike ku një temë trajtohet në 3 orë laboratorit dhe punohet veçantë ditën e shtunë dhe të djelë për studentë që paraqesin vështirësi **[nga takimi me stafin akademik, takimi me studentët]**. Pjesëmarrja në punën laboratorike është 80% e detyrueshme por synohet të bëhet 100% **[nga RVB, takimi me stafin akademik, takimi me studentët]**.

Kolegji Profesional i Tiranës ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi midis tij dhe sipërmarrjeve private për ushtrimin e praktikave mësimore. Studentët të cilët dallojnë (shfaqin interes në punësim si dhe kanë rezultate pozitive gjatë ushtrimit të praktikës mësimore) kanë mundësinë të punësohen pranë kompanive që kryejnë praktikën. Kjo mundësohet në rast se kompanitë kanë nevojë për personel.

Konkluzionete GJV:

GJV ka konstatuar se Programi i studimit jouniversitar, profesional pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në "Mekatronikë" është zhvilluar në funksion të kërkesave dhe nevojave të tregut të punës për të pasur personel të kualifikuar. Studentët të cilët do të ndjekin studimet në "Mekatronikë" do të pozicionohen në një zonë të ndërmjetme, midis inxhinierit elektrik, mekanik dhe teknikut të mesëm. Këta studentë kanë mundësi të punësohen dhe si operatorë të makinerive inteligjente (makinerive me komanda numerike CNC, etj), kjo për arsye se këto makineri kërkojnë personel të kualifikuar jo vetëm për venien në punë të tyre por edhe për mirëmbajtjen e tyre.

KPT ka siguruar ngritjen e disa laboratorëve të cilët janë në funksion të kurrikulës dhe kualifikimi të personelit. Kontratat e lidhura me sipërmarrjet private nga njëra anë dëshmojnë interesin e tyre për personel të kualifikuar ndërsa nga ana tjetër interesin e KPT për përmirësimin e kurrikulës dhe aftësimin e studentëve.

Do të shihet në interes që të forcohet qëndra e karrierës në institucion. Nëpërmjet kësaj qëndre studentët do të mund të merrin më shumë informacion në lidhje me tregun e punës dhe në lidhje me ngritjen e sipërmarrjeve të tyre.

2. Struktura akademike e NjësisëBazë(përgjegjëse për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për personelin akademik në njësinë bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera të institucionit.

Programi i studimit jouniversitar, profesional pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë në "Mekatronikë" mbulohet nga dy departamentet e KPT, nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara. Dy departamentet janë krijuar me vendim të senatit akademik që mban datën 05/12/2016 dhe numër protokollit 22. Departamenti përgjegjës për zhvillimin e kurrikulës është departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ndërkohë që departamenti i Teknologjisë së informacionit ka karakter mbështetës. Secili prej departamenteve drejtohet nga përgjegjësi i



departamentit. Detyrat e përgjegjës të departamentit janë të përcaktuara në statutin e KPT si dhe në aktet rregulluese.

Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ka nën varësinë e tij 7 (shtatë) laboratore dhe 3 (tre) ofiçina nga të cilat 5 (pesë) laboratore dhe 2 (dy) ofiçina shërbejnë dhe për zhvillimin e kurrikulësë "Mekatronikë".

Në funksion të programit të studimit KPT ka instaluar dhe laboratorin e Robotikës. Kur grupi i vlerësimit ishte për vizitë në ambientet e KPT, laboratori ishte në proces montimi dhe komisionimi.

Personeli akademik i Departamentit që mbulon programin e studimit për vitin akademik 2017-2018 është i përbërë nga 26 persona. Personeli është i ndarë në personel akademik me kohë të plotë (personel akademik efektiv) 13 persona, nga të cilët 3 me grada/ tituj akademikë dhe personel akademik me kohë të pjesshme (personel akademik me kontratë) 13 persona, nga të cilët 3 me grada/ tituj akademikë.

Tregues të matshëm:

Struktura didaktike e Departamentit/sectorët

Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ka nën varësinë e tij 7 (shtatë) laboratore dhe 3 (tre) ofiçina nga të cilat 5 (pesë) laboratore dhe 2 (dy) ofiçina shërbejnë dhe për zhvillimin e kurrikulësë "Mekatronikë". Laboratorët dhe ofiçinat janë si më poshtë:

1. Laboratori i HVAC dhe termo teknikës.
2. Laboratori i pneumatikës dhe elektropneumatikës, PLC.
3. Laboratori i fizikës.
4. Laboratori i mekanikës dhe shkencave të materialeve.
5. Laboratori i elektronikës së automobilave
6. Ofiçina e HVAC dhe termoteknikës.
7. Ofiçina e makinave elektrike.
8. Oficina e automobilave.

Numri i personelit akademik në Departament: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Tabela 1, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 1

Viti akademik	Stafi akademik i Departamentit							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i Stafit të ftuar		Numri i Stafit administrativ	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
2015 - 2016	16	2	3	1	*	N/A	*	N/A
2016 - 2017	11	3	15	5	*	N/A	*	N/A
2017 - 2018	13	3	13	3	*	N/A	*	N/A

Personelit akademik në Departament, titujt/gradat, (Tabela2, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

TKS

IAL: Kolegji Profesional i Tiranës Departamenti: Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara						
PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Marenglen Gjonaj	Përgjegjës Departamenti	Prof.Dr.	1	Miranda Kullolli	Prof.As. UPT
2	Antoneta Deda	Pedagoge Përgjegjëse e Zyrrës së Kurrikulave dhe NJSBC	Prof.Dr.	2	Elfrida Topçiu	Dr. Pension
3	Arben Dushi	Pedagog	Prof.As.	3	Idajet Selmani	Msc. Shkolla e mesme Zall Bastar
4	Pirro Dhimitri	Pedagog	Msc.	4	Luiza Dhimitri	Msc. Nuk punon në institucione të tjera
5	Konti Tafa	Pedagog	Msc.	5	Migena Zeqo	Msc. UPT
6	Ilir Palushaj	Pedagog	Msc.	6	Marsida Ibro	Msc. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
7	Teuta Halilaj	Pedagoge	Msc.	7	Preni Muça	Msc. Në pension
8	Marjeta Dhima	Pedagoge	Msc.	8	Zamira Rira	Ba. Nuk punon në IAL tjetër
9	Artur Ruzi	Pedagog	Msc.	9	Memush Habilaj	Msc. Në pension
10	Vladimir Sinani	Pedagog	Msc.	10	Malvina Marku	Msc. UT – Fakulteti i Shkencave të Natyrës
11	Leon Merja	Pedagog	Msc.	11	Emiliano Qose	Msc. Nuk punon në IAL tjetër
12	Sashenka Avrami	Pedagog	Msc.	12	Genc Salja	Msc. Nuk punon në IAL tjetër
13	Gerald Shkreta	Pedagog	Msc.	13	Përparim Lika	Msc. Nuk punon në IAL tjetër

Te dhenat e tabelës janë marre te rifreskuara gjate vizites ne IAL

- Sa më sipër mbështetur në Statutin e Institucionit (Anekset në DVV)
- Sa më sipër mbështetur në Rregulloren e Institucionit (Anekset në DVV)
- Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL, gjatë vizitës: Staf akademik për departamentin e Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, Institucioni ku punojnë full time

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për Programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Sot programi i studimit "Mekatronikë" në Kolegjin Profesional të Tiranës mbulohet nga një staf akademik prej njëzet e gjashtë(26) personash. Lëndët e formimit të përgjithshëm dhe ato me karakter profesional mbulohen pjesërisht nga personel akademik me grada dhe tituj dhe pjesërisht nga personel akademik pa grada dhe titujshkenicorë.

Trembëdhjetë (13) pedagogë janë efektivë, nga të cilët dy janë me gradën Prof.Dr. një është me gradën Prof.As. ndërsa pjesa tjetër e personelit ka gradën MSC dhe MP.

Trembëdhjetë (13) pedagogë janë të jashtëm nga të cilët, një është me gradën Prof.Dr. dy janë me gradën Dr. ndërsa pjesa tjetër e personelit ka gradën MSC dhe një pedagog është pa gradë dhe titull akademik.

Numri i vogël i studentëve të rregjistruar gjatë dy viteve të parë bën që personeli administrativ të jetë në funksion të të gjithë institucionit dhe jo i ndarë në funksion të programit mësimor. Ai është i përbërë nga katërbëdhjetë (14) anëtarë.

Përzgjedhja e stafit akademik bëhet mbi bazën e manualit të përgatitur nga zyra e burimeve njerëzore. Ndër kriteret kryesore të përzgjedhjes vlen të përmendet eksperiencia në mësimdhënie në nivel universitar, zoterimi i një diplome të paktën në Master Profesional. Rekrutimi për stafin me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e marrëveshjes institucionale të lidhur midis universitetit përkates dhe KPT [takim me pergjegjesin e departamentit, takim me burimet njerëzore].

Ne takimin me stafin akademik u evidentua veshitësia e rekrutimit të një stafi profesional për këtë program mesimor. Kryesisht punohet në rritjen profesionale të stafit të ri përmes përthithjes së studenteve me të mirë sik është shembulli i një studenti nga Bachelor [takim me stafin akademik].

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për programin e studimit (Tabela 3, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 2

Stafi akademik i Programit të Studimit Mekatronikë						
PAE (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Shpëtim Bozdo	Prof.Dr.	1	Migena Zeqo	Msc	UPT
2	Marenglen Gjonaj	Prof.Dr.	2	Ilir Shinko	Dr	
3	Antoneta Deda	Prof.Dr.	3	Esmeralda Bërdufi	Msc	
4	Arben Dushi	Prof.As.	4	Fatmir Basholli	DR	Universiteti "Albanian University"
5	Pirro Cipo	Prof.Dr.	5	Erjon Mali	Msc	
6	Ervin Suli	Msc.	6	Anisa Curraj	Msc.	
7	Konti Tafa	Msc.	7	Marsida Ibro	Msc	
8	Teuta Halilaj	Msc.				
9	Marjeta Dhima	Msc.				
10	Artur Ruzi	Msc.				
11	Gerald Shkreta	Msc.				
12	Petro Plasa	MND				
13	Dritan Karriqi	Msc				
14	Ervin Anastasi	Msc				
15	Pirro Dhimitri	Msc				
16	Erjon Curraj	Msc				
17	Thimi Oço	Msc				

Shënim: Kjo Tabelë është hartuar mbështetur në Tabelën e RVB, fq25-26

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 4

Titulli	Programi Mësimor Mekatronikë		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	4	0	4/0
Profesorë të As.	1	0	1/0
Doktorë	0	2	0/2
MND	1	0	1/0
Msc	11	5	11/5
Gjithsej	17	7	17/7

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat, Ngarkesa semestrale, vjetore etj

Shpërndarja e ngarkesës mesimore për personelin akademik kryhet në përputhje me kontaktën individuale të punës lidhur midis personit dhe KPT. Personeli akademik me kohë të plotë ka një ngarkesë vjetore prej 360 orësh mesimore, (orë në auditor). Rekrutimi i stafit kryhet në përputhje me nevojat që ka institucioni për personel akademik. Kërkesat për personel akademik i paraqiten bordit drejtues i cili më pas vendos për hapjen e vendeve të lira për pedagogë. Kërkesat dhe nevojat për personel akademik publikohen në faqen e internetit të KPT.

Përzgjedhja e stafit bëhet nga një komision i veçantë pas dorëzimit të dokumentacionit nga personat e interesuar për tu punësuar në institucion. Përzgjedhja e stafit bëhet në disa etapa, së pari është seleksionimi i kandidatëve dhe më pas është intervista me kandidatët. Pas përfundimit të intervistave komisioni zgjedh kandidatin me pikët më të larta. Procedurat e zgjedhjes së stafit jo akademik në KPT janë të ngjashme me ato të stafit akademik vetëm se nuk kanë si kriter punësimin në mesimdhënie. Midis strukturave mesimdhënese dhe strukturave administrative ekziston një bashkëpunim i ngushtë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës: Ngarkesa mesimore per Mekatronike, 2016-2017

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi 2 Aftësi të transferueshme janë zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar gjatë gjithë programit
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Punëdhënësit ndihmojnë në përcaktimin e përvojave thelbësore (p.sh. përvoja e punës) dhe aftësitë ndër-kurrikulare, qëndrimet dhe njohuritë (p.sh. të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, komunikimi, TIK, marrëdhëniet me klientët)</p> <p>Kriteri 2 Çdo aftësi është ndjekur përmes moduleve (Përmbajtja e kursit, metodat e mesimdhënies, vlerësimi) në fazat e zhvillimit të kurrikulës dhe nëpërmjet rishikimit tëprogramit.</p> <p>Kriteri 3 Rezultatet janë të monitoruara (p.sh. punësimi i të diplomuarve).</p>
<p><u>Vlerësimi sipas standardit 2:</u></p> <p>Bashkëpunimi midis TIK dhe subjekteve private për realizimin e praktikave mesimore synon dhe evidentimin e studentëve më të mirë. Gjatë zhvillimit të praktikës studenti ka mundësi të shfaqë aftësitë e tij, të japë mendim për zgjidhjen e problemeve të cilat mund të shfaqen. Studenti me mbështetjen dhe kontrollin e tutorit të praktikës mund të veprojë për të realizuar objektivin e vendosur gjatë zhvillimi të praktikës. Studentëve të cilët shfaqin interes për tu punësuar mund të punësohen në subjektet private në të cilat zhvillojnë praktikën. Punësimi i tyre do të varet dhe nga kërkesat e subjektit për fuqi punëtore në drejtimin respektiv.</p> <p>Përpara regjistrimit studentët informohet në lidhje me programin mesimor, mënyrën e zhvillimit të tij, pajisjen e tyre me materialet e duhura, bazën laboratorike, etj. Bazuar në syllabuset e programit mesimor dhe vizitën e zhvilluar në institucion rezultojnë se për programin mesimor të degës “Mekatronikë” studentët i fitojnë aftësitë profesionale nga disipinat e formimit të përgjithshëm dhe nga disipinat e formimit profesional. Në kurrikulën e degës “Mekatronikë” janë parashikuar 6 lëndë mesimore të formimit të përgjithshëm dhe 14 lëndë mesimore të formimit profesional.</p> <p>Disipinat e formimit profesional janë të ndara në dy grupe, disiplina të formimit karakterizues dhe disiplina të formimi të zgjedhura nga studentët. Lëndët e formimit profesional janë të ndara në:</p> <ul style="list-style-type: none">- lëndë të formimit profesional me karakter elektrik (mbështeten në shkencat e inxhinierisë elektrike)- lëndë të formimit profesional me karakter mekanik (mbështeten në shkencat e inxhinierisë mekanike) si dhe- lëndë formimit profesional me karakter elektronik (mbështeten në shkencat e inxhinierisë

elektronike).

- Në programin mësimor janë parashikuar dhe lëndët mësimore të kombinuara si Robotika dhe Mekatronika.

Lëndët mësimore janë të ndara në leksione, seminare dhe laboratore. KPT nëpërmjet laboratorëve të instaluar synon të sigurojë kuptimin praktik të lëndëve mësimore. Për zhvillimin e orës së leksionit përdoren metoda të ndryshme. Në shumë raste ekziston kombinimi i metodave klasike me metodat e reja të mësimdhënies, si përdorimi i paketës së Microsoft Office, etj.

Orët e seminarit zhvillohen në auditor dhe ndiqen metodat klasike të zhvillimit të orës së seminarit. KPT për degën "Mekatronikë" ka instaluar dhe labororet. Pjesa teorike e cila zhvillohet në sallat e leksioneve dhe seminareve implementohet në praktikë duke gjatë orëve të laboratorit.

Zhvillimi i orës së laboratorit bazohet mbi punën individuale të studentit por nën ndjekjen e vazhdueshme të pedagogut përgjegjës. Bazuar në dokumentacionin e institucionit për programin mësimor "Mekatronikë" rezultojnë se për të hyrë në vlerësimin final studenti duhet të ketë ndjekur mbi 60% të leksioneve, 60% të seminareve dhe 80% të laboratorëve. Vlerësimi i studentëve është i ndarë në tre pjesë, vlerësimi për aktivizimin në orët e seminarit dhe zgjidhjes së ushtrimeve (10% të vlerësimit total), vlerësimi mbi plotësimin e detyrimeve laboratorike (30% të vlerësimit total) dhe provimi përfundimtar (60% të vlerësimit total).

Programi "Mekatronikë" ka vetëm dy vjet që është hapur dhe nuk ka ndryshime në kurrikulën e miratuar.

Bazuar në vizitën e kryer rezultojnë se institucioni ka informacion në lidhje me aftësitë dhe njohuritë e fituara nga studentët si dhe për aplikimin e tyre në fushën praktike. Ky informacion është marë nga punësimi me kohë të pjesshme i disa prej e studentëve. Diplomat e para në programin e studimit "Mekatronikë" i përkasin fundit të periudhës së vitit akademik 2017-2018 (provimi i formimit i cilinë përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë zhvillohet në muajin korrik, 2018) kjo bën që institucioni të mos ketë një tabelë të punësimit të studentëve ose një vlerësim të plotë të aftësive të fituara prej tyre.

Standardi 5: Stafit zotëronaftësi, sjellje dhe përvojë të duhur për rezultatet e pritshme të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Të dhëna nga specialistë të sektorit përkatës të punësimit

Kriteri 2 Stafit mësimdhënës angazhohet në përditësimin e mëtejshëm, specifikisht për anën profesionale, lëndët dhe vendet e punës

Kriteri 3 Janë ngritur sisteme për evidentimin e hershëm dhe ofrimin e mbështetjes, për mbështetjen e të mësuarit tek studentët

Kriteri 4 Stafit ka siguruar mbështetje për studentët me kohë të pjesshme (part time), p.sh. nëpërmjet email-it, ofrimin të të mësuarit virtual dhe ambienteve përkatëse (e-learning).

Vlerësimi sipas standardit 5:

Punësimi i stafit akademik është realizuar nga zyrra e burimeve njerëzore të KPT. Kriteret për punësimin e personelit akademik për programin "Mekatronikë" janë vendosur nga departamenti dhe grupi i vlerësimit të brendshëm në konsultim me rektorin e KPT. Në kriteret e punësimit është vendosur përvoja përvoja akademike dhe eksperiencia në punë (ekperiencia në fushat e prodhimit dhe montimit). Mëqënëse në strukturat drejtuese të institucionit janë pedagogë me grada dhe tituj shkencorë, ata kanë përdorur eksperiencën dhe njohjen e tyre për rekrutimin e stafit akademik.

Bazuar në verifikimin e dosjeve të personelit akademik rezultojnë se ata përveç kualifikimit që i karakterizon (diploma e shkollës së lartë) kanë certifikata dhe diploma të kualifikimeve në drejtime specifike por në përputhje të plotë me programin mësimor të cilin ata zhvillojnë.

KPT ka ngritur strukturat e evidentimit dhe ofrimin të mbështetjes ndaj studentëve. Strukturat drejtuese të KPT dhe stafit akademik kanë realizuar platforma software të cilat mundësojnë marrjen e informacionit

didaktik dhe informimin e studentëve në lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor. KPT ka ngritur infrastrukturën e bibliotekës, atje gjenden cikle leksionesh të shkruara, ushtrime të zgjidhura dhe shembuj praktikë të cilat ndihmojnë në mbarëvajtjen e procesit të formimit dhe kualifikimit.

KPT nuk siguron ndjekjen e studimeve me kohë të pjesshme dhe në distancë

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në pikat e standardit 2 dhe 5 mund të themi se KPT ka ndërtuar infrastrukturën e cila mundëson lidhjen midis tij dhe biznesit. Nëpërmjet metodave të zhvillimit dhe vlerësimit të ushtrimit të praktikës gjatë orëve laboratorike dhe praktikës profesionale në qendrat e biznesit KPT synon të evidentojë studentët më të mirë. Nëpërmjet ecurisë së studentëve gjatë praktikës profesionale KPT synon të marrë informacionin e duhur në lidhje me zhvillimin e kurrikulës mësimore për degën "Mekatronikë". Infrastruktura e ngritur për zhvillimin e lëndëve mësimore mundëson mbarëvajtjen e procesit mësimor. Bazur në diskutimin me stafin akademik dhe studentët rezultojnë se KPT ka informacion në lidhje me punësimin e studentëve dhe ecurinë e tyre në vendet e punës.

Do të ishte pozitive ngritja e një databaze e cila të siguronte një informacion të plotë në lidhje me punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve. Do të ishte pozitive që KPT të ofronte mundësinë e qendrës së karrierës dhe orientimit të studentëve për ndërtimin e CV-ve dhe mundësinë e afrimit të tyre me kompanitë e rekrutimit të forcës së punës.

Stafi akademik që mbulon programin mësimor "Mekatronikë" përbëhet nga 17 pedagogë personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 pedagogë personel akademik me kontratë (PAK). Në rast se flasim me përqindje rezultojnë se 60% e programit mësimor sigurohet nga PAE, 25% nga personeli PAK dhe 25% nga bashkëpunimi midis PAE dhe PAK. Në total me përqindje rezultojnë se 72% nga PAE dhe 28 % nga PAK.

Punësimi i stafit akademik realizohet në funksion të kërkesave të departamentit dhe rekrutohet nga një komision i ngritur nga strukturat drejtuese të KPT. Kualifikimi i stafit akademik përkon me qëllimin e vendosur nga institucioni për realizimin e kurrikulës.

Stafi akademik zotëron certifikata dhe diploma kualifikimi. KPT do të duhej të shpallë një strategji të kualifikimit të mëtijshëm të stafit akademik në funksion të zhvillimit të kurrikulës, duke e konsideruar të plote kualifikimin aktual.

KPT ka ngritur strukturat e mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe aftësimin profesional të studentëve. Strukturat software sekretaria mësimore mundësojnë informimin e studentëve në lidhje me ecurinë e procesit mësimor. KPT nuk siguron ndjekjen e studimeve me kohë të pjesshme dhe në distancë.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Bazuar në dokumentacionin e verifikuar rezultojnë se adresa e KPT është si më poshtë: Njësia bashkiake nr.4, rruga "Xhenfize Keko", Kompleksi Xhura, zone kadastrale 8130 me numër pasurie 5/200, Tiranë. Bazuar në kontratën e qerasë rezultojnë se sipërfaqja totale e institucionit është 2,500 m² ndërkohë që sipërfaqja totale e kompleksit është 12,000 m².

Mësimi zhvillohej në një ndërtesë me katër kate (Godina 2), ku ambientet e vëna në dispozicion të procesit mësimor (auditore, laboratorë dhe zyra) ndodheshin në katin e parë (1020 m²), në katin e dytë (480 m²) dhe në katin e katërt (1200 m²). Përpos këtyre ambienteve, në kontratën e qirasë përfshiheshin edhe 280 m² që ndodheshin në godinën e quajtur Godina 1C, kati përdhes, që përdroreshin si ofiçina në ndihmë të procesit mësimor.

Në katin e parë të ndërtesës ndodhen zyrat e rektorit, pedagogëve, ndodhen salla të cilat përdoren për leksione ose seminare. Në katin e parë ndodhet biblioteka dhe fotokopja. Në kat të parë ndodhet dhe një sallë laboratorike në të cilën kryhen labororet e elektronikës auto, PLC, dhe sistemeve pneumatike.

Në katin e katërt të ndërtesës ndodhen zyrat e sekretarisë mësimore, labororet e elektronikës, sallat e kompiuterave dhe salla seminaresh dhe leksionesh. Ndërkohë që laboratori i sistemeve të HVAC (ngrohje ftohje, sistemet e kondicionimit dhe vendilimit), laboratori (ofiçina) i pjesëve mekanike të automobilave dhe laboratori (ofiçina) i makinave elektrike ndodhen në një ndërtesë tjetër dhe ka një sipërfaqe prej 280 m². KPT e ka emërtuar godina C.

Zyra e burimeve njerëzore dhe financës ndodhet në një godinë tjetër. Pjesa tjerë e hapësirës përfshin lulishte, hapësirë për parkimin e mjeteve dhe një bar kafe. Bazuar në dokumentacionin e ofruar rezultojnë se për numrin aktual të studentëve hapësirat janë të mjaftueshme.

Vihet re mungesa e asensorëve midis kateve. Për lëvizjen midis kateve përdoren shkallët. KPT ka të plotësuar kushtet e sigurisë teknike dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ambientet e KPT janë të pajisura me sistemet e kondicionimit dhe ngrohjes. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me materialin e nevojshëm didaktik dhe mundësohet zhvillimi normal i leksioneve dhe seminareve. Sallat janë të pajisura me vidioprojektor. Gjatë verifikimit rezultojnë se infrastruktura mësimore ishte në gjendje pune. Sistemi kompiuterik i ngritur mundësonte aksesimin e materialeve në të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve.

Mjediset e institucionit janë në funksion të të gjithë programeve të studimit. Oraret mësimore bëjnë të mundur që ambientet e KPT të jenë në shfrytëzohen nga të gjithë programet e studimit dhe mos të ketë përplasje midis tyre. Bazuar në numrin ekzistues të studentëve si dhe sipërfaqet që institucioni disponon rezultojnë se aktiviteti mësimor kryhet nga ora 8.00 deri më orën 15.00.

Për akomodimin e studentëve të cilët nuk banojnë në Tiranë institucioni ka lidhur një kontratë akomodimi me Qytetin e Studentëve. Numri i studentëve të akomoduar në godinat e Qytetit Studenti është në funksion të vendeve të lira që ai disponon. KPT nuk disponon mjedise sportive për veprimtarinë e qeverisë studentore.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e institucionit në funksion të programit të studimit (Tabelat 5, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabelat 5

Mjediset për Kolegjin(për programin e studimit)	Sasia	Sipërfaqja [m ²]
Salla për leksione	5	510.05 m ²
Klasa për seminare/ushtrime	7	307.4 m ²
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	4	284.8 m ²
Laboratorë për lëndët	6	310.8 m ²
Laboratorë informatike	4	238.6 m ²
Salla për bibliotekë	1	89.6 m ²
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	27.4 m ²
Zyrë informacioni për studentët	1	
Korridore/holle		512.6 m ²
Mjedis shërbimi për të tretë	1	38.5 m ²

TK6

R

Nyje hidrosanitare për studentët	6	112.2 m ²
Ambient teknik	1	32 m ²
Shkallë		166.4 m ²
Salla për leksione	5	510.05 m ²
Klasa për seminare/ushtrime	7	307.4 m ²
Salla për praktikë lëndore/ profesionale	4	284.8 m ²
Norma m²/për student		5.17 m²/student

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja [m ²]
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore		
Zyra për personelin akademik	6	163.07 m ²
Zyrë për financën	1	10 m ²
Zyrë për Njësinë e SBC	1	20 m ²
Mjedis për stafin e shërbimit	5	134 m ²
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	1	22.2 m ²
Norma m²/për person		8.95 m²/për person

Pra normativat plotësohen

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

KPT është një institucion i arsimit të lartë privat të ardhurat e institucionit sigurohen nga veprimtaria ekonomike e administratorëve të institucionit si dhe nga tarifa e regjistrimit të studentëve. Institucioni ka dy vjet që ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit të lartë. Burimet e financimit janë të ndryshme dhe kjo lidhet drejt për drejt me numrin e studentëve të regjistruar. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në vitin e parë të akademik institucioni i ka siguruar të ardhurat nga tarifat e shkollimit të studentëve dhe nga veprimtari të ndryshme ekonomike. Ndërkohë që vitin e dytë të aktivitetit të ardhurat e institucionit janë siguruar vetëm nga tarifat e regjistrimit të studentëve.

Konrolli financiar dhe menaxhimi i fondeve realizohet nga zyra e financës dhe administratori i KPT. Kërkesat për fonde financiare vijnë kryesisht nga stafik akademik dhe përgjegjësit e laboratorëve. Pas miratimit në departament kërkesat i drejtohen bordit drejtues i cili miraton dhe fondet përkatës. Miratimi final i fondit bëhet nga administratori i KPT. Projekti buxhetit analizohet nga administratori i KPT dhe më pas miratohet nga bordi i aksionarëve të KPT. Ndjekja e procedurave financiare kryhet nga zyrra e financës. Kryerja e procedurave financiare bazohet në ligjet e Shtetit Shqiptar.

Duke qenë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk) ky institucion u nënshtrohet të gjitha rregullave dhe legjislacionit shqiptar për shpk-të. Pra ai është subjekt kontrolli nga autoritetet shtetërore.

Ky institucion paraqet një qendrueshmeri financiare. Investimet e kryera në laboratore dhe krijimin e mjediseve të reja mesimore të eprshatshme për orët e laboratorëve dhe leksioneve tejkalojnë të ardhurat e perftuara nga tarifat studendore. Keto shpenzime nga janë mbuluar nga bordi i investitoreve. Ndonese numri i paket i studenteve për këtë program nuk justifikon shpenzimet për stafin akademik, bordi i investitoreve është i gatshëm të vazhdojë investimet në permiresimin e kushteve laboratorike sepse në terma afatgjate ky investim do të jete shumë pozitiv [takim me Rektorin, takim me përgjegjës të departamentit].

T/05

R

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Tabela 6, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 6

Të ardhurat (në lekë) nga:	Viti 1 (2015)	Viti 2 (2016)
Pushteti qendror		
Pushteti vendor		
Grantet për kërkim dhe kontratat		
Konsulencat, shërbimet		
Tarifat (regjistrim/shkollim/etj)	23%	100%
Sponsorizimet		
Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm)		
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj		
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	77%	
SHUMA	100%	100%

- Shpenzimet për vitet e zhvillimit të programit sipas burimit të financimit

Shpenzimet e institucionit përkohë me aktivitetin dhe qëllimin e themelimit të tij. Në shpenzimet e institucionit hyjnë pagat e stafit akademik dhe jo akademik, shpenzimet për blerjen dhe mirëmbajtjen e laboratorëve, shpenzimet për mirëmbajtjen e infrastrukturës mësimore si kompjutera, fotokopje, shtypja dhe publikimi i materialeve didaktike, sistemet e ndriçimit, sinjalistika, etj.

Nga dokumentacioni i ofruar rezultojnë se shpenzimet janë bërë në funksion të aktivitetit dhe qëllimit statutor të KPT në zërat: Pagat e personelit akademik e jo akademik, blerje të pajisjeve laboratorike dhe mirëmbajtje të tyre, Blerje dhe mirëmbajtje pajisjesh ndihmëse (si laptop, kompjutera, video projektor, etj.), për materiale didaktike, mirëmbajtje, etj.

- Kosto e studimit/për student për një vit akademik

Kostoja për student është përcaktuar nga bordi drejtues i KPT dhe ajo është 195,680.00 lek për student. Tarifa e studimit është 2200 EURO për 1 vit studimesh, mënyrën e pagimit me tre kështe, përkatësisht 800, 700, 700; në rast se pagesa për të gjitha vitet mësimore ose për një vit mësimor bëhet njëherësh atëherë studenti do të përfitonte një ulje të tarifës së shkollimit (bonus) për 1 vit 200 Euro dhe për dy vitet 400 EURO.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Funksionimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Bazuar në ligjin e arsimit të lartë KPT ka themeluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Njësia ka nisur punë në datën 28/12/2015 dhe në vazhdim. Në NjSBC bëjnë pjesë gjashtë anëtarë. Grupi i sigurimit të cilësisë është i ndërtuar nga pedagogë të cilët mbulojnë programin mësimor "Mekatronikë" nga antarë të stafit të njësive ndihmëse të KPT nga një ekspert i jashtëm dhe një student.

Funksionimi dhe kompetencat e NJSBC bazohem në: "Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimi e NJSBC në Kolegjin Profesional të Tiranës".

Nga takimi me grupin e vlerësimit të cilësisë u vërejt se funksionet e tyre janë, ndjekja e vazhdueshme e zhvillimit të programit mësimor, kontrolli dhe rishikimi i kurrikulave dhe syllabuseve mësimore, përmbushja e programit mësimor nga pedagogu i lëndës, ngritja e infrastrukturës që shërben për vlerësimin e pedagogëve, përpilimi i materialeve vlerësuese.

NJSBC zhvillon aktivitetin bazuar në një plan kalendarik të përvitshëm. Plani përkon me zhvillimin e kontrolleve, mënyrën e kontrollit, ndërtimin e pyetësorit, etj. NJSBC zhvillon kontrole dhe gjatë orës së mësimit. Pas kryerjes së kontrollit NJSBC harton raportin të cilin e dorëzon pranë departamentit që mbulon programin mësimor "Mekatronikë".

Njësisia organizon kontrollin e pedagogëve të rinj 1 herë në semestër. Vlerësimi i pedagogëve nga studentët bëhej në javën e 12 apo 13, duke gjykuar që në këtë periudhë studentët kanë përvojë të mjaftueshme për të dhënë gjykim objektiv. Në vazhdim u informuam edhe për kontrollet e ushtruara gjatë zhvillimit të provimit si dhe në vlerësimin e studentëve.

Sa i përket procesit mësimor, GVJ u informua lidhur me kriteret që vendosen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënjes nga studentët, marrëdhëniet e njësisë me tutoriatin, roli që ka NJSBC në vendimmarrje si dhe mënyrën e përpunimit e vlerësimit të informacioneve të marra. Në përgjigje të këtij interesimi, GVJ gjykon që NJSBC në këtë institucion është aktive dhe ndikimi i aktivitetit të saj në sigurimin e brendshëm të cilësisë është i matshëm.

Tabela 7

Nr.	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Antoneta Deda	Kryetare	Dhjetor 2016 - vazhdim
2	Ervin Suli	Anëtar	Dhjetor 2015 - vazhdim
3	Teuta Halilaj	Anëtar	Dhjetor 2015 - vazhdim
4	Jola Osmënaj	Anëtar	Dhjetor 2016 - vazhdim
5	Beniamin Disha	Student	Dhjetor 2017 - vazhdim
6	Odeta Cati	Ekspert i Jashtëm	Dhjetor 2015 - vazhdim

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre.
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Për të gjitha pikat e mësipërme mendojmë se:

NJBSC në aktivitetin e saj ka realizuar praktikisht kontrole në mbështetje të programit mësimor bazuar mbi një program të detajur pune. Krahas kontrolleve NJSBC ka realizuar edhe anketimet e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, mënyrën e shpjegimit të pedagogëve gjatë leksioneve, mënyrën e organizimit të seminareve dhe laboratorëve, etikën e komunikimit me studentët, mënyrën e menaxhimit të kohës së vënë në dispozicion për zhvillimin e programit mësimor, qartësinë e formulimit të tezave të provimit, objektivitetin në vlerësimin e përgjigjeve, angazhimin për të plotësuar mungesat e konstatuara në plotësimin e detyrimeve etj. Në takimin e zhvilluar me Përgjegjësen e NJSBC u informuam që hartimi i pyetësorit mbështetëj kryesisht në eksperiencën e grupit të njësisë si dhe në bashkëpunimin me tutoriatin. Këto anketime kryheshin në çdo fund semestri. Secili student kishte plotësuar formularin e tij në mënyrë anonime duke u fokusuar në lëndën

konkrete. Pas plotësimit të formularëve, të dhënat e tyre ishin sistemuar në tabela për tu përpunuar më tej nga sekretaria e departamentit. Interesimit të GVJ lidhur me problemet e dalta për programin e studimit "Mekatronikë" nga këto intervistime, përgjegjësja e NjBSC iu përgjigj që derimëtani nuk janë evidentuar probleme që të konsiderohen. Këtë pohim e konstatuam edhe gjatë konsultimit të aneksit 16 "Raportet e NjBSC" si dhe materialeve që na u vunë në dispozicion nga institucioni. Edhe në takimin me studentët, ku nuk merrnin pjesë pedagogët, pyetja e GVJ lidhur me shqetësimet që kanë patur ata për ecurinë e procesit mësimor rezultoi të jetë: nuk kemi patur shqetësime për t'u konsideruar.

Dokumentacioni përkatës i marrë në IAL , gjatë vizitës

Interesimit të GVJ për të marrë dokumenta plotësuese lidhur me aktivitetin e NjBSC, zyra përkatëse iu përgjigj duke në vënë në dispozicion:

- Relacione mbi vlerësimin e studentëve për pedagogun dhe lëndën (Gerald Shkreta dhe Fatmir Basholli)
- Relacione për zhvillimin e kontrolleve gjatë zhvillimit të provimeve
- Formular për vlerësimin e pedagogëve të rinj nga profesori përgjegjës
- Raporte mbi kontrollin e syllabuseve.

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në dokumentacionin egzistues lidhur me aktivitetin dhe produktet e NjBSC në departamentin e EMSA, në vartësi të të cilit është program i studimit "Mekatronikë", GVJ konstaton që ky aktivitet është kryer konform dispozitave ligjore dhe rregulloreve përkatëse.

Produktet e këtij aktiviteti kanë ndikuar në mbajtjen gjallë të frymës së kontrollit, kryesisht të punës së personelit akademik si dhe respektimit të detyrimeve kontraktuale si nga ana e tij ashtu edhe institucionit.

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Terma reference: përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Koleji profesional i Tiranës ka hapur për herë të parë programin e studimit profesional dy vjeçar në Mekatronikë në vitin akademik 2016-2017, së bashku me disa programe të tjera studimi.

Institucioni ka rishikuar planin mësimor (Tabela 9) dhe përfundimisht i rishikuar është paraqitur në Tabelën 8. Mendojmë ky rishikim ka përmirësuar variantin e parë, sepse:

- Janë përshtatur më mirë emërtimet e lëndëve
- Është rritur praktika profesionale
- Janë zëvendësuar lëndët, duke ju përshtatur më mirë qëllimit dhe objektivave të programit

Tregues të matshëm:

Organizimi i programit të studimit (në vite/semestra/javë)

- Viti akademik është organizuar në 30 javë, i ndarë në 2 semestar me nga 15 javë
- 1 vit ka mesatarisht 60 kredite
- 1 kredit ka 25 orë punë të studentit
- 1 orë mësimore ka 60'

Plani mësimor është organizuar në kredite (ECTS) duke mundësuar transferimin e krediteve për studentët.

Nga analiza e krediteve përbërese për cdo lëndë rezulton se raporti midis formave të mësimdhënies është **49 kredite** për leksione/**37 kredite** për ushtrime/**17 kredite** për laboratore/**17 kredite** për praktikë profesionale dhe teme diplome. Pra raporti teori : praktikë është është **50 % : 50 % (59 kredite/61 kredite)**.

Plani mësimor është organizuar në lëndë të formimit bazë, lëndë të formimit karakterizues, lëndë integruese, lëndë me zgjedhje dhe lëndë formuese si anglisht, informatikë, apo praktikë profesionale. Gjithashtu në fund të studimeve studentët i nënshtrohen provimit përfundimtar /ose mbrojnë një temë diplome.

Emërtimi i Diplomës:

Diplomë profesionale dy vjecarejouniversitare në Mekatronikë

Plani mësimor

Plani mësimor për programine studimit jepet në Tabelën 8 (sipas plani mësimor që IAL ka paraqitur në RVB).

TKS

R

Tabela 8

Viti I/(Viti II) Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore						Punë e Pavarur	Gjithsej								
				Leksione		Seminare		Laborator				Praktikë							
				ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur			ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur					
1	Matematikë	I	4	3	2	14	36	2	24	26				38	62	100	2		
2	Anglisht	I	4	3.5				4	48	52				48	52	100	1		
3	Fizikë e Përgjithëshme	I	5	4.5	2	14	36	2	24	26	1	21	4	59	66	125	1		
4	Vizatim Teknik dhe Autocad	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
5	Hyrie në Teknologjine e Informacionit	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
6	Bazat Teorike të Qarqeve Elektronike	I	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
7	Hyrie në Mekatronikë	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	2		
8	Bazat e Mekanikës Strukturale	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
9	Termoteknikë e Aplikuar	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
10	Bazat e Mekanikës së Aplikuar dhe Elemente Mak.	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
11	Makina Elektrike	II	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
12	Materiale Inxhinierike dhe Metrologji	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
13	Bazat e Mekanikës së Fluideve	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
14	Instrumente elektrike e elektronike	III	4	3.5	2	14	36	1	12	13	1	21	4	47	53	100	1		
15	Robotikë	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
16	Bazat e Rrjetave	IV	4	3.5	2	14	36	1	12	13	1	21	4	47	53	100	1		
17	Mekatronikë 2	IV	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
18	Pneumatikë Industriale	IV	4	3.5	2	14	36	1	12	13	1	21	4	47	53	100	1		
19	Praktikë Profesionale	IV	10	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	210	40	250	1	
LËNDË ME ZGJEDHJE																			
20	Kontrolli elektromekanik	III	6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4	66	84	150	1		
21	Bazat e sipërmarries	III	6	4	4	28	72	2	24	26				52	98	150	1		
PROVIMI FORMIMI/ TEMË DIPLOME																			
22	Temë diplome Provimi formimi	IV	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	147	28	175	1	
TOTAL			120	119	49	343	882	37	444	481	17	357	68	17	357	68	1534	1566	3100

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Tabela 9, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 9

Viti /Viti II Lëndë/Module	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provine
			Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë						
			ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
2		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
3		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
4		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
5		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		4	3	2	14	36	2	24	26						38	62	100	2
		6	5	3	21	54	2	24	26	1	21	4			66	84	150	1
		5	4.5	2	14	36	2	24	26	1	21	4			59	66	125	1
		4	4.5	2	14	36	2	24	26	1	21	4			59	66	125	1
		4	3.5				4	48	52						48	52	100	1
		7											7	147	28	175	1	
		10											10	210	40	250	1	
		6											6	126	24	150	1	
		7											7	147	28	175	1	
		21																

Ndryshimet në programin mësimor në total janë 21 kredite, që përbëjnë 17.5 % të programit në total (120 kredite). Pra ndryshimet janë brenda kriteve ligjorë.

- Kuadri i përgjithshëm formues i Programit të studimit (Tabela10, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 10

Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli		Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)	1	Matematikë	4	15
	2	Fizikë e Përgjithëshme	5	
	3	Vizatim Teknik e AutoCAD	6	
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	1	Bazat Teorike të qarqeve elektronike	6	58
	2	Materiale Inxhinierike/metrologji	6	
	3	Robotikë	6	
	4	Hyrje në mekatronikë	6	
	5	Bazat e mekanikës strukturale	6	
	6	Termoteknikë e aplikuar	6	
	7	Bazat e mekanikës së aplikuar/elemente makinash	6	
	8	Bazat e mekanikës së fluideve	6	
	9	Mekatronikë 2	6	
	10	Pneumatikë industriale	4	
Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)	1	Makina elektrike	6	14
	2	Instrumente elektrike dhe elektronike	4	
	3	Bazat e rrjetave	4	
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Lëndë me zgjedhje 1			6
	1	Kontroll elektromekanik	6	
	Lëndë me zgjedhje 2			
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)	1	Anglisht	4	20
	2	Hyrje në teknologjinë e informacionit	6	
	3	Praktikë profesionale	10	
Provimi përfundimtar (F)	1	Temë Diplomimi/Provimi diplomimi	7	7

- Vlerësimi i Syllabus-eve për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Vlerësimi i Syllabus-eve nga ana cilësore

GVJ i shqyrtoi të gjitha sylabuset e lëndëve që përfshihen në kurrikulën e programit të studimit “Mekatronikë” dhe konstatoi që hartimi i tyre është bërë sipas formatit të kërkuar. Tek paragrafi ushtrime, në shumicën e syllabuseve është shënuar: “Ushtrimet mbulojnë gjithë gamën e problemeve në përputhje me programin e lëndës”, ndërkohë që mund të listoheshin tipe të grupuara ushtrimesh.

Sa i përket përmbajtjes së tyre GVJ vlerëson se ata e japin të plotë problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj. Duke gjykuar që sylabuset janë në proces përmirësimi të vazhdueshëm rekomandojmë përshtatjen e tyre sipas kërkesave të tregut, zhvillimit të teknologjisë, propozimeve e sugjerimeve të studentëve etj

- Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabela 11, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 11

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti ku është me kohë të plotë	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE/PAK
1. Matematikë	Shpëtim Bozdo Ervin Suli	Prof.dr. Msc.	Teknologjisë së Informacionit	38	PAE
2. Anglisht	Petro Plasa	MND	Teknologjisë së Informacionit	48	PAE
3. Fizikë e Përgjithëshme	Antoneta Deda Teuta Hallilaj	Prof.Dr. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	59	PAE PAE
4. Vizatim Teknik Autocad	Migena Zeqo Gerald Shkreta	Msc. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK PAE
5. Hyrje në Teknologjinë e Informacionit	Ilir Shinko Esmeralda Bërdufi	Dr. Msc.	Teknologjisë së Informacionit	66	PAK PAK
6. Bazat Teorike të Qarqeve Elektronike	Pirro Cipo Dritan Karriqi Ervin Anastasi	Prof.dr. Msc. Msc.	Teknologjisë së Informacionit	66	PAE PAE PAE
7. Hyrje në Mekatronikë	Fatmir Basholli	Dr.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
8. Bazat e mekanikës strukturale	Arben Dushi Migen Zeqo	Prof.As. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE PAE
9. Termoteknikë e Aplikuara	Pirro Dhimitri	Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
10. Bazat e Mekanikës së Aplikuara/ Elementë Makinash	Marenglen Gjonaj Konti Tafa	Prof.Dr. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE PAE
11. Makina Elektrike	Dritan Karriqi	Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
12. Materiale Inxhinjierike/ Metrologji	Pirro Dhimitri	Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
13. Bazat e Mekanikës së Fluideve	Marjeta Dhima Artur Ruzi	Msc. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAE
14. Kontroll Elektomekanik	Erjon Mali	Msc.	Teknologjisë së Informacionit	66	PAK
15. Bazat e sipërmarrjes	Erjon Curraj Anisa Curraj	Msc. Msc.	Teknologjisë së Informacionit	52	PAE PAE
16. Instrumente Elektrike/Elektronike	Dritan Karriqi Thimi Oço	Msc. Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	47	PAE PAE
17. Robotikë	Marsida Ibro	Msc.	Teknologjisë së Informacionit	47	PAK
18. Bazat e rjetave	Gerald Shkreta	Msc.	Elektro Mekanikës dhe	47	PAE

				Sistemeve të Aplikuara		
19	Mekatronikë 2	Fatmir Basholli	Dr.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	66	PAK
20	Pneumatikë Industriale	Gerald Shkreta	Msc.	Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara	47	PAE

Vlerësimi sipas standardeve:

<p>Standardi 6: Struktura e programit, rezultatet e të mësuarit dhe proceset e vlerësimit të mësimdhënies janë në përputhje me standardet evropiane.</p>
<p>Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:</p> <p>Kriteri 1 Programi është në përputhje me Bolonjën, Përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.</p> <p>Kriteri 2 Studentët janë të pajisur me Suplementin e Diplomës që përputhet me rregulloret e BE-së për diplomim</p> <p>Kriteri 3 Arritjet në nivelin 4 në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, lejojnë regjistrimin në këtë program studimi</p> <p>Kriteri 4 Studentëve të regjistruar me formim dhe njohuri të ndryshme nga prurjet e zakonshme (jo tradicionale) u ofrohet mbështetje e duhur që në fazat e hershme të programit.</p> <p>Kriteri 5 Programit ka 120 ECTS dhe lejon transferimin në vitin e 3, të një programi bachelor.</p> <p>Kriteri 6 Ka një raport të balancuar 50:50 praktikë / teori në programin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin studentëve.</p> <p>Kriteri 7 Rreth 25% e programit është i vendosur në punë konkrete (p.sh. në një semestër ose i vendosur në pushimet e verës) ose në shkëmbime ndërkombëtare (p.sh. Erasmus +).</p> <p>Kriteri 8 Mësimi praktik dhe elementëve të punës konkrete u është dhënë pesha e duhur në vlerësim dhe rivlerësim.</p>
<p><u>Vlerësimi sipas standardit 6:</u></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e ofruar rezultoni se programi mësimor është në përputhje me kartën e Bolonjës, përshkruesit e Dublinit dhe Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Programi mësimor është në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>KPT është licencuar në vitin 2015 po hapja e programit mësimor "Mekatronikë" përkon me vitin 2016 dhe diplomimi i grupit të parë të studentëve i përket me vitin 2018. Provimi i diplomës ose Tema e diplomës vërteton përfundimin e ciklit të studimeve për degën "Mekatronikë" të studentëve të vitit të dytë do të duhet të zhvillohet në muajin korrik të vitit 2018. Nga takimet e zhvilluara me stafin akademik si dhe stafin drejues të KPT, si dhe nga dokumentacioni i parqitur prej tyre u vërejt se në përfundim të ciklit të studimeve studentët do të pajiseshin me diplomë dhe suplementin e saj. Studentët e programit mësimor "Mekatronikë" pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi kanë përfunduar detyrimet e programit mësimor (pasi janë diplomuar) dhe pasi kanë përfunduar plotësisht detyrimet financiare kundrejt KPT.</p> <p>Studentët të cilët pranohen në KPT për të kryer studimet në degën "Mekatronikë" duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm profesional ose të përgjithshëm si dhe të kenë përfunduar me sukses maturën shtetërore (të kenë marrë notë kaluese në provimet e maturës shtetërore). Studenti duhet të zotërojë diplomën e shkollës së mesme të përgjithshme ose profesionale. KPT në programin e studimit "Mekatronikë" mundëson regjistrimin e studentëve pa pasur si kriter mesataren e shkollës së mesme, kjo është në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë për kolegjet profesionale.</p> <p>Në programin e studimit "Mekatronikë" mund të regjistrohen dhe studentë të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm jashtë Republikës së Shqipërisë me kushtin që diploma të cilën ata zotërojnë që jetë e ekuivalentuar në një prej cikleve të studimit të arsimit të mesëm. Gjithashtu mund të ndjekin studimet dhe studentë ose persona të tjerë të cilët kanë përfunduar arsimin e lartë. KPT mundëson transferimin e</p>

studentëve nga universitetet publike ose jo. Transferimi i studentëve nga Universitetet publike ose në drejtim të KPT për programin e studimit "Mekatronikë" mbështetet në kuadrin ligjor të transferimit të studimeve. Në rast se studenti ka përfunduar me sukses programin e studimit "Mekatronikë" ka mundësi të transferohet në një nga programet e studimit të nivelit Bachelor por transferimi kryhet në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë si dhe me kriteret e vendosura nga Universiteti pritës.

Studentët mund të kërkojë transferimin dhe njohjen e krediteve si dhe ekuivalentimin e lëndëve me programe mësimore të ngjashme. Aktualisht në degën "Mekatronikë" studiojnë dhe studentë të cilët kanë ardhur nga universitete të tjera por ata nuk kanë kërkuar transferimin e studimeve dhe kjo ka bërë që ata të rregjistrohen si studentë të rinj.

Bazuar në ligjin e arsimit të lartë një student kalon nga një vit akademik në një vit tjetër akademik kur ka shlyer 50% të programit mësimor pra ka marë 30 kredite. Një student i KPT ka të drejtë të transferohet në vitin e tretë të studimeve të një programi Bachelor pas verifikimit të programit mësimor të kurrikulës së degës "Mekatronikë" Verifikimi në këtë rast bëhet nga institucioni ku student i kërkon të transferohet.

Programi është strukturuar në 120 kredite. Studentët e degës "Mekatronikë" kanë një formim profesional, ku një pjesë e lëndëve mësimore kanë si qëllim aftësimin e njohurive në fushën e shkencës së inxhinierisë elektrike dhe elektronikëndërsa pjesa tjetër e lëndëve mësimore kanë si qëllim aftësimin e njohurive në fushën e shkencës së inxhinierisë mekanike.

Disiplinat e formimit të përgjithshëm (A) dhe disiplinat e veprimtarisë formuese (C dhe E) zenë 49 kredite dhe disiplinat e formimit karakterizues 64 kredite.

Programi mësimor është ndarë në leksione laboratore dhe seminare si dhe praktikën profesionale. Në programet mësimore nuk janë përcaktuar detyra kursi të cilat të mundësojnë një punë plotësisht të pavarur të studentit. Bazuar në ndarjen e krediteve midis orëve të teorisë dhe orëve të praktikës mësimore (laboratore, seminare dhe praktikë profesionale) të programit mësimor të degës "Mekatronikë" rezulton se plotësohet kriteri i një raporti të balancuar 50:50, teori, praktikë. Por në rast se e shohim në totalin e orëve mësimore (orë në auditor dhe punë e pavarur) që student i kryhen në praktikë dhe orëve që student i zhvillon teori rezulton raporti 49.4 : 50.6 midis teorisë dhe praktikës.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar si dhe në vizitën e kryer rezulton se KPT për të gjitha degët studimore ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Thesalisë, në Greqi. Nënshkrimi i memorandumit ka për qëllim krijimin e mundësive të lëvizjes së studentëve dhe personelit akademik.

Gjatë dy viteve akademike (koha e liqensimit të programit mësimor) nuk ka pasur mobilitet të studentëve dhe stafit pedagogjik.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit të degës "Mekatronikë" është ndërtuar në funksion të Kartës së Bolonjës, përshtetësia e Dublinit dhe Kornizës Europiane të Kualifikimeve. Programi mësimor është në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë. Programi mësimor është i ndërtuar nga 120 kredite. Rregjistrimi i studentëve për vitet është bërë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë. Rregjistrimi i studentëve për dy vitet akademike (2016-2017 dhe 2017-2018) është bërë me anë të portalit të maturës shtetërore.

Programi i studimit "Mekatronikë" ka si qëllim aftësimin e studentëve në tre drejtime, në drejtim të përdorimit, mirëmbajtjes, riparimit të pajisjeve osesistemeve të automatizuara elektrike dhe në drejtimin e mirëmbajtjes, riparimit të automobilave. Bazuar në programet mësimore themi se studentët të cilët përfundojnë studimet në degën "Mekatronikë" do të qëndronjë në një pozitë të ndërmjetme midis specialistit të lartë (inxhinierit me diplomë bachelor Mekatronikë) dhe teknikut të ulët (mekanikut,

elektricitit, personave që kanë mbaruar studimet në shkollat e mesme profesionale). Meqënësesë këto dy degë të shkencave ekzakte kanë një përhapje shumë të gjërë si dhe fusha e mbulimit është shumë e madhe do të ishte më mirë sikur KPT për degën "Mekatronikë" të siguronte një program fleksibël duke rritur numrin e lëndëve me zgjedhje por duke mbajtur të pa ndryshuar kreditet e tyre.

Programi mësimor ka një ndarje të rregullt midis lëndëve me karakter mekanik (lëndë të shkencave të inxhinierisë mekanike) lëndëve me karakter elektrik (lëndë të shkencave të inxhinierisë elektrike) dhe lëndëve me karakter elektronik (lëndë të shkencave të inxhinierisë elektronike).

Një numër më i lartë i lëndëve me zgjedhje do të mundësonte një kualifikim më të mirë të studentëve. Në rast se do të risim numrin e lëndëve me zgjedhje studenti do të zgjidhte sipas interesit të tij dhe dëshirës së tij për t'u specializur në më shumë lëndë me karakter mekanik ose më shumë lëndë me karakter elektrik, elektronik. Kjo do të mundësonte specializimin në një drejtim më të ngushtë.

Do të ishte pozitive që në disa lëndë mësimore të shtohet dhe detyra e kursit ose e projektit në mënyrë që studenti të kryente një punë sa më të pavarur.

Në lidhje me programin mësimor do të bëja disa sugjerime si më poshtë:

Lënda mësimore "Bazat Teorike të Qarqeve Elektronike" të emërtohet "Bazat Teorike të Qarqeve Elektrike dhe Elektronike" ose "Elektroteknika e Aplikuar"

Programet e lëndëve mësimore "Bazat e Mekanikës së Fluideve" dhe "Pneumatikë Industriale" duhet të rishikohen në mënyrë që lëndët të bashkohen dhe të krijohet një modul i vetëm.

Lënda mësimore "Robotikë" do të ishte më mirë të studiohej pas përfundimit të lëndës "Pneumatikë Industriale" dhe "Mekatronikë 2"

Do të sugjeroja zvogëlimin e kreditimeve për disa lëndë dhe shtimin e lëndëve si "Transmisione Elektrike" dhe "Elektronikë Fuqie"

Si lëndë me zgjedhje do të sygjeroja "Makinat Elektrike Speciale" .

Si lëndë me zgjedhje do të sygjeroja dhe disa lëndë me karakter profesional si "Detajet e Makinave" lëndë mësimore të cilat të japin informacion në lidhje me makinat metal punuese, makinat ngritëse, pompave, etj.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies përkon me natyrën e programit të degës "Mekatronikë" mësimdhënia është e organizuar në leksione, laboratore dhe seminare. Leksionet zhvillohen në salla të mëdha me kapacitet pranues për 70 studentë. Për zhvillimin e orës së leksionit përdoren metoda të ndryshme. Në shumë raste ekziston kombinimi i metodave klasike me metodat e reja të mësimdhënies, si përdorimi paketës së Microsoft Office, PowerPoint, etj.

Zhvillimi i seminareve kryhet në grupe më të vogla studentësh. Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezultojnë se një grup seminari është i formuar nga 25 studentë. Në rastin e programit të studimit "Mekatronikë" numri i studentëve ka qënë i vogël (6 dhe 9 studentë) prandaj leksionet dhe seminarat janë

zhvilluar për një grup dhe për lëndët të cilat janë të njëjta me programet e tjera të studimit grupet e studentëve të mekatronikës janë bashkuar me ata të elektro-mekanikës.

Zhvillimi i laboratorëve kryhet në grupe më të vogla në funksion të punës së laboratorit dhe lëndës që zhvillon laboratorin. Organizimi i punëve të laboratorit në degën “Mekatronikë” bëhet në grupe prej 3, 5 ose 12 studentësh. Bazuar në dokumentacionin e institucionit për programin mësimor “Mekatronikë” rezulton se për të hyrë në vlerësimin final studenti duhet të ketë ndjekur mbi 60% të leksioneve, 60% të seminareve dhe 80% të laboratorëve. Vlerësimi i studentëve është i ndarë në tre pjesë, vlerësimi për aktivizimin në orët e seminarit dhe zgjidhjes së ushtrimeve nga e cila merr 10% të vlerësimit total, vlerësimi mbi plotësimin e detyrimeve laboratorike nga e zhvillimi i të cilave merr 30% të vlerësimit total dhe provimi përfundimtar nga i cili merr 60% të vlerësimit total. Pedagogët e programit “Mekatronikë” zhvillojnë konsultime dhe ndjekin aftësimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës mësimore. Njohuritë e studentëve testohen jo vetëm në provimin përfundimtar por edhe në provime të ndërmjetme ose testimeve gjatë orëve të seminarit. Notat e mara gjatë testimeve përfshihen në vlerësimin e orës së seminarit.

Rektorati i KPT së bashku me NjSBC kontrollon mbarëvajtjen e procesit mësimor. KPT për degën “Mekatronikë” ka ngritur sistemin e tutoriatit [RVB, takimi me stafin akademik, takimi me shefin e departamentit]. Profesori i ngarkuar ndjek problematikat e studentëve në lidhje me zhvillimin e lëndës mësimore, vështirësitë që ata shfaqin, sugjerimet e tyre dhe më pas i paraqet ato në departament nga ku merren dhe masat përkatëse. Nga dokumentacioni i siguruar rezulton se për numrin ekzistues të studentëve në të gjitha degët e KPT pedagogët e departamentit i cili mbulon programin mësimor “Mekatronikë” kanë një ngarkesë vjetore prej 350 orësh në auditor e arritur përmes nje harmonizimi midis Administratorit dhe Vendimit të Senatit Akademik [takimi me shefin e departamentit]. Studentët e dy viteve të para nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të KPT kjo për arsyen se institucioni momentalisht ofron vetëm mësimdhënie dhe nuk ofron aktivitete në nivel shkencor ku studentët mund të përfshiheshin. KPT ka përfshirë vetëm 6 studentë për zhvillimin projekteve të brendshme në përputhje me programin e studimit “Mekatronikë”.

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Tabela 12, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 12

Programi i Studimit Jouniversitar 2 vjeçar “Elektro Mekanikë”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	343
Seminare	444
Laboratore	357
Praktikë lëndore	0
Praktikë profesionale	210
Diploma	147
Në total	1501

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 13, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 13

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, etj)	30%
Testimet gjatë vitit	0%
Provimi përfundimtar	60%

Etj	0%
Në total	100%

- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Tabela 14, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 14

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për projekte/praktika në rang Institucioni	6
Për punime individuale të pedagogëve	Nuk ka
Për projekte /praktika në rang Departamenti	Nuk ka
Për projekte në bashkëpunim me të tjerë	Nuk ka

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Procedurat e pranimit të studentëve kanë ndryshuar në funksion të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë si dhe aktet nën ligjore të tij. Që në vitin e parë të çeljes së programit mësimor, viti akademik 2016-2017 dhe në vazhdim pranimi i studentëve është kryer nëpërmjet portalit të maturës shtetërore. Aplikimi u krye në formë elektronike në faqen zyrtare të maturës shtetërore. Procesi i pranimit të studentëve u kontrollua nga Agjensia Kombëtare e Provimeve si dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit Nr.13, datë 22/07/2016 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimit me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2016-2017". Aplikimi i maturantëve për degën "Mekatronikë" është zhvilluar online. Pas përfundimit të aplikimeve Agjensia Kombëtare e Provimeve ka dërguar pranë institucionit listën e studentëve të cilët dëshironin të ndiqnin programin e studimit për degën "Mekatronikë".

Në vitin e parë të çeljes së programit të studimeve janë rregjistruar 6 studentë ndërsa në vitin e dytë të janë rregjistruar 9 studentë.

Programi i studimit është 2 vjeçar dhe në fund të vitit akademik 2017-2018 KPT për programin "Mekatronikë" do të ketë studentët e parë të diplomuar. Nga mbikëqyrja e dokumentacionit rezultojnë se nota mesatare e regjistrimit të studentëve është relativisht e ulët, për vitin akademik 2016-2017 është 6÷7 dhe për vitin akademik 2017-2018 është 5÷7.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar rezultojnë se studentët e vitit akademik 2016-2017 janë në përfundim të ciklit të studimeve dhe kohëzgjatja e studimeve është 2 vjeçare për të gjithë studentët e regjistruar. Bëjnë përjashtim vetëm studentët që kanë ndërprerë studimet me dëshirën e tyre. Koha e çeljes së programit të studimit "Mekatronikë" është shumë e shkurtër si (studentët nuk janë diplomuar) rezultat institucioni nuk ka statistika në lidhje me punësimin e tyre.

Institucioni ka ndërtuar infrastrukturën strukturën e cila meret me promovimin e programit mësimor për programin “Mekatronikë”. Informacioni i nevojshëm për programin e studimit publikohet në disa forma: si materiale të shkruara ose të shtypura në formën e fletëpalosjes, në forma elektronike si në faqen e internetit të institucionit, në tabela ose kënde informimi (orari i mësimave, salla respektive, pedagogu i lëndës, etj). Për informin e nxënësve të shkollave të mesme të cilët do të duan të ndjekin studimet në programin mësimor “Mekatronikë”, KPT zhvillon dhe vizita dhe takime informuese në ambient e shkollave të mesme.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 15, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 15

Programi i studimit 2 vjeçar jouniversitar në “Elektro Mekanikë”	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2016	6	6.12	N/A	N/A
2017	9	5.94	N/A	N/A
2018	Nuk ka filluar rregjistrimi	-	-	-
Në total	15	6.03	N/A	N/A

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk rezultojnë studentë të transferuar. Rezultuan 2 studentë të c’regjistruar

- Të dhëna për punësimin e studentëve (Tabela16 vetëm në rastin e riakreditimit)

Tabela 16

Periudha e të dhënave (2016-2018)			
Programi i studimit jouniversitar 2 vjeçar në “Mekatronikë”	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
	N/A	N/A	N/A

Vlerësimi sipas standardeve:

Standardi 3: Qasja e studentëve në mësimdhënie është mbështetur përmes hartimit të programit

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Hartimi i Programit të studimit është mjaftueshëm fleksibel për të mundësuar që studimi të përshtatet me punësimin.

Kriteri 2 Përvojat e studentëve të fituara nga puna e tyre e mëparshme, janë integruar në modulet dhe vlerësimin e studentëve.

Kriteri 3 Përmbytja e Programit është aktuale dhe i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe/ose kërkesat për aftësitë/shprehjet nga punëdhënësit.

Kriteri 4 Vlerësimi dhe feedback-u i studentëve është përdorur në mënyrë efektive, për të mbështetur studentët jo tradicionale dhe të mësuarit e nxënësve me performancë të ulët

Kriteri 5 Mësimdhënia përfshin metoda të ndryshme pedagogjike që i përshtaten studentëve të ndryshëm, p.sh. të mësuarit në veprim, puna në ekip dhe të mësuarit në formë të pavarur.

Vlerësimi sipas standardit 3:

Programi i studimit "Mekatronikë" mundëson që studenti të marrë njohuri në fushën e shkencave të inxhinierisë elektrike, elektronike dhe shkencave të inxhinierisë mekanike. Bazuar në njohuritë e fituara studenti ka mundësi të punësohet pranë qendrave të punës të cilat kanë në përdorim makineri dhe pajisje të automatizuara ose pranë pikave të riparimit të automobilave.

Bazuar në syllabuset e programit mësimor rezultojnë se janë të orientuara më shumë drejt praktikës, drejt zhvillimit të orëve laboratorite (21 orë në laborator për kredit) dhe orëve të seminarit (12 orë në auditor për seminar/për kredit), orët e leksioneve janë (7 orë në auditor për kredit)

Për të siguruar një fleksibilitet më të lartë të programit mësimor do të duhej rritja e numrit të lëndëve me zgjedhje. Kjo do të siguronte kualifikimi më të lartë brenda qëllimit të programit por në një drejtim më të ngushtë, pra studenti do të ishte më i specializuar në drejtimin e robotëve industrialë ose të automobilave.

Puna e laboratorit dhe puna e seminarit luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e studentit. Ato zenë 40% të notës finale. Puna e laboratorit vlerësohet në masën 30% të notës përfundimtare dhe aktivizimi në seminare dhe në zgjedhje ushtrimesh në masën 10% të notës finale. Ndërsa provimi përfundimtar vlerësohet në masën 60% të notës finale.

Programimësimor i hartuar siguron specializimin e përgjithshëm në programin "Mekatronikë". Për të plotësuar kërkesa të veçanta të profesionit në drejtimin "Mekatronikë" do të duhej të rritej numri i lëndëve me zgjedhje. Programi i hartuar plotëson kriteret e tregut të punës për specialistë në fushën respektive. Specialistë të cilët duhet të jenë të aftë në mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive.

Mënyra e vlerësimit si dhe orgazimi i orëve mësimore mundësojnë përkrahjen e studentëve me performancë të ulët. Ora e laboratorit zhvillohet në grupe të vogla studentësh dhe kjo mundëson pjesëmarrjen e të gjithëve gjatë zhvillimit të saj.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se pedagogët organizojnë seanca konsultimi me studentët. Seancat e konsultimit organizohen përpara sezonit të provimeve ose gjatë kohës së zhvillimit të procesit mësimor.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultojnë se organizimi i laboratorëve realizohet në mënyrë të tillë që studentët të punojnë në grup. Një shembull i punës në grup të studentëve është dhe zhvillimi i praktikës profesionale.

Standardi 4: Rezultatet e të mësuarit komunikohen që nga pranimi i studentëve deri në diplomim dhe janë shqyrtuar dhe vlerësuar

Indikatorët e suksesit në zbatimin e këtij standardi mund të përfshijnë:

Kriteri 1 Informacioni për mundësitë e regjistrimeve është i qartë dhe i publikuar, si dhe i mbështetur me udhëzime ndihmuesetë stafit.

Kriteri 2 Ekziston një praktikë efektive e punës në ekip, midis stafit të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe stafit të IAL.

Kriteri 3 Synimet e programit dhe rezultatet e të mësuarit për elementët praktikë dhe akademikë janë të qarta, të mbështetura nga publikimi i rezultateve të të mësuarit në nivel moduli

Kriteri 4 Monitorimi i bibliotekës dhe i burimeve të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënës është bërë rregullisht. Janë ndërmarrë rregullisht praktika specifike të punësimit dhe zhvillimi i aftësive.

Vlerësimi sipas standardit 4:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezultojnë se mënyrat me të cilat studentët informohen për tu regjistruar në programin "Mekatronikë" të KPT është e përcaktuar në "Politikën e procedurat e komunikimit të KPT". KPT organizon takime informuese me nxënësit e shkollave të mesme. Fton për vizitë në ambientet e KPT nxënësit e shkollave të mesme. Shpërndan materiale informuese dhe reklama

promocionale. KPT mer pjesë rregullisht në panaiet e karrierës. KPT përdor faqen zyrtare në internet për informimin në kohë reale të nxënësve dhe studentëve të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në programin “Mekatronikë”.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se KPT për programin e studimit “Mekatronikë” ka bashkëpunuar më disa institucione të arsimit të lartë dhe ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi sidomos në fushën akademike. Marrëveshjet e nënshkuara janë midis UPT (Universitetit Politeknik Tiranë) Univesitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. KPT duhet të bashkëpunojë dhe me stafin e Arsimit dhe Formimit Profesional sidomos për zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe programeve studimore.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton se synimet e programit janë të qarta. Rezultatet mësimore për elementët praktikë dhe akademikë janë të mbështetura në nivel moduli.

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar rezulton se biblioteka është e pajisur me materiale didaktike sidomos cikle leksionesh të shkruara, libra dhe materiale të tjera plotësuese. KPT për degën “Mekatronikë” duhet të ketë një plan më të detajuar për pasurimin e bibliotekës më materiale didaktike dhe etapat që do të ndiqen për realizimi e tij. Ciklet e leksioneve, materialet laboratorike dhe materiale plotësuese të programit të studimit “Mekatronikë” gjenden dhe në portalin on-line të KPT.

Konkluzionet e GVJ:

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar si dhe vizitën e zhvilluar në ambientet e KPT rezulton se:

Programi studimor “Mekatronikë” i KPT është i orientuar në drejtimin praktik të të nxënësve. Punët laboratorike dhe orët e seminarit luajnë një rol të rëndësishëm të vlerësimit të studentit. Kjo duket dhe nga mënyra e vlerësimit, 40% e notës finale.

Programi mësimor i hartuar siguron specializimin e përgjithshëm në programin “Mekatronikë”.

Mënyrat e vlerësimit të studentëve, mënyra e organizimit të orëve mësimore, seancave të konsultimeve, etj bën të mundur përkrahjen e studentëve me performancë të ulët. Institucioni i vë rëndësi dhe punës në grup. Kjo duket nga mënyra e organizimit të laboratorëve dhe praktikës profesionale.

Metodat e informimit për programin mësimor “Mekatronikë” janë të përcaktuara. KPT zhvillon takime me nxënësit e shkollave të mesme si dhe me grupet e interesit për të promovuar programin e studimit.

KPT ka lidhur kontrata bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë sidomos në fushën e bashkëpunimit akademik.

Në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të programit mësimor vlerësohej një bashkëpunim më i plotë me stafin e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së materialeve didaktike KPT për programin “Mekatronikë” duhet të krijojë një grup shkencor i cili të kontrollojë nga ana cilësore botimet e cikleve të leksionve, materialet laboratorike etj.

10. Aktivitetet profesionale në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e njohurive me praktikën profesionale, vlerësimet zyrtare të aktivitetit individual të studentëve ose në njësinë.

KPT ka investuar në krijimin e një ambienti miqësor, të shëndetshëm dhe bashkëpunues midis studentëve. KPT nxit pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete në ndryshme në nivelit akademik, social, kulturor që zhvillohen nga institucione të ndryshme, të arsimit të lartë ose jo. KPT ka iniciuar krijimin e klubeve studentore dhe klubit të inovacionit. Nëpërmjet klubit të inovacionit KPT kërkon nxitjen e bashkëpunimit të studentëve të degëve të ndryshme. Nëpërmjet bashkëpunimit KPT kërkon rritjen e besueshmërisë së punës në grup, lindjen e mendimit të bashkëpunimit e studentëve në zhvillimin e projekteve me interes për institucionin si dhe programet mësimore, etj. Studentët e Kolegjit kanë marë pjesë në disa aktivitete të zhvilluara nga palë të treta. Këto aktivitete kanë pasur karakter formues.

Krahas aktiviteteve studentore KPT për programin "Mekatronikë" nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në aktivitete në ndryshme me karakter shkencor dhe didaktik. Departamenti përgjegjës për programin studimor së bashku me zyrën e burimeve njerëzore ka ndërtuar një plan për mobilitetin e stafit akademik dhe trajnimin e mëtejshëm të tyre. Për momentin kjo përkon me trajnimin e stafit akademik për përdorimin me efektivitet të bazës laboratorike të siguruar nga kompania Polytech. Koha e çeljes së programit mësimor "Mekatronikë" është shumë e shkurtër dhe institucioni është në etapat e para të pjesëmarrjes në aktivitete me karakter akademik.

11. Bashkëpunimi kombëtar(dhe ndërkombëtar)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Bashkëpunimet e realizuara nga njësi kryesore me tregun e punës që lidhet me këtë program studimi, si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel kombëtar/ ndërkombëtar. Përfitimet institucionale, në nivel program apo në nivel studentësh gjatë këtyre bashkëpunimeve.

KPT për degën "Mekatronikë" ka realizuar dy forma bashkëpunimi kombëtar. Së pari Kolegji Profesional i Tiranës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe sipërmarrje private dhe publike në mënyrë që studentët të kryejnë praktikat profesionale si dhe të njihen me punën në terren. Marrëveshjet e siguruara për realizimin e praktikës mësimore/profesionale përkojnë me kompani të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e riparimit të automobilave. Nëpërmjet marrëveshjeve studentëve të programit në "Mekatronikë" u mundësohet përshtatja me punën në teren, njohja me problematikat reale, ata kanë mundësinë të venë në realitet idetë e tyre por nën supervizionin e personave përgjegjës.

KPT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë në mënyrë që të sigurojë mbulimin e programit mësimor me personel të kualifikuar, të sjellë pranë institucionit praktikat më të mira të mësimdhënies si dhe të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulave.

Institucioni ka në plan të shtrijë bashkëpunimin me institucione të huaja të cilat ofrojnë programe të ngjashme mësimore në mënyrë që të rritë cilësinë e programeve mësimore, të realizojë kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik, etj.

Lista e subjekteve me të cilat KPT ka marrëveshje për realizimin e praktikave profesionale të studentëve

	Subjekti	Vendndodhja	Afati i lidhjes së Kontratës
1	Rapid repair	Tirane	Pa afat
2	Hyundai Auto Albania shpk	Tirane	Pa afat
3	Servis Auto shpk	Tirane	Pa afat

TKS

[Signature]

4	Besland shpk	Tirane	Pa afat
5	ESC ECO Climate Solution sha	Tirane	Pa afat
6	Gjeo – Vjosa shpk	Tirane	Pa afat
7	Samina Auto 4x48	Tirane	Pa afat
8	Qendra e Shërbimit të Mjeteve të transportit në Ministrinë e Brendëshme	Tirane	Pa afat
9	Artinel 95 shpk	Tirane	Pa afat
10	A.D.S 02 shpk	Tirane	Pa afat
11	Bardha Group	Tirane	Pa afat
12	Uni-Klima shpk	Tirane	Pa afat
13	Anion shpk	Tirane	Pa afat
14	Njësia kombëtare e Ozonit	Tirane	Pa afat

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar /ndërkombëtar (Tabela 17, mbështetur në të dhënat e RVB dhe të konfirmuara gjatë vizitës)

Tabela 17

Aktivitete individuale ose në rang Institucioni, në kuadër të bashkëpunimit kombëtar në vitet e fundit		
1	Orë mësimore (leksione/seminare dhe praktika) të realizuar nga lektorë të huaj:	N/A
2	Orë mësimore (leksione/seminare dhe praktika) të realizuar nga lektorë vendas	N/A
3	Numri i pjesëmarrjeve në trainime fushën e trainimit profesional jashtë vendit	N/A
	etj	

TKS

ANALIZA SWOT

Analiza përmblendhëse sipas metodës SWOT(Strengths, Weaknesses-, Opportunities, Threats).

a. Pika të forta:

- KPT është institucioni i parë në fushën e arsimit profesionale i cili është i kategorizuar Kolegj Profesional, po ashtu edhe programi studimor “Mekatronikë” 2-vjeçare
- KPT për stafin akademik dhe jo akademik ka të garantuar një mjedis pune profesional me standarde të larta.
- Investimet në materiale didaktike dhe laboratorë kanë sjellë përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të mësimdhënies dhe të përforcimit të njohurive nga ana e studentëve
- Kushtet e zhvillimi të orëve mësimore në auditor janë në standarde të larta. Sallat e zhvillimit të leksioneve seminareve etj, plotësojnë kriteret e zhvillimit optimal të orës mësimore.
- Bashkëpunimi midis KPT dhe qendrave të bizneseve (ndërmarrjeve prodhuese) krijon mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të kurrikulave mësimore si dhe zhvillimin me efektivitet të praktikave mësimore.
- Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara ka një staf të kualifikuar. Ka personel me grada dhe tituj akademikë.
- Ka ngritje të infrastrukturës softëare në mbështetje të programit mësimor dhe informimit të studentëve në kohë reale.
- Ekzistojnë aftësi financiare dhe infrastrukturore për të zgjeruar ambientet ku zhvillohet mësimdhënia.

b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):

- Koha e shkurtër e programit të studimit.
- Mungesa e një numri më të madh lëndësh me zgjedhje brenda programit mësimor “Mekatronikë”, me anë të të cilave të realizohet një profilizim më i ngushtë i studentit.
- Mungesa e një rishikimi të syllabuseve nga pikëpamja e cilësisë së gjuhës në shkrimin shkencor të materialit didaktik, dhe të përdorimit të një simbolike uniforme, etj.

c. Mundësitë:

- Ekzistojnë kapacitete në drejtim të:
 - a) pasurimit të mëtejshëm të laboratorëve për programin studimor “Mekatronikë”, si psh pasurimi i laboratorit të makinave elektrike.



- b) ndërtimit dhe zbatimit të një plani të qartë financiar për kualifikimin dhe mbështetjen e stafit akademik.
- c) lidhjes së marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit me institucione jashtë vendit të cilat ofrojnë programe mësimore të të njëjtit nivel. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve të sigurohet dhe lëvizja e stafit akademik dhe lëvizja e studentëve.

d. Pengesat:

- Koha e shkurtër e zhvillimit të këtij programi studimi (2 vite eksperiencë, dhe akoma nuk kanë dalë diplomantët e parë).
- Kostot e larta të blerjes së laboratorëve dhe pajisjeve didaktike
- Mos zbatimi i standardeve në mirëmbajtjen, riparimin dhe diagnostikimin e defekteve të sistemeve elektromekanike, automatike nga ana e sipërmarrësve privatë dhe publikë dëmton zhvillimin e kurrikulës mësimore si dhe të kualifikimit të mëtejshëm të punonjësve të përfshirë në këto shërbime që sjell reduktimin e numrit të studentëve të regjistruar, krahasuar me kërkesat e tregut të punës.
- Mos respektimi i ligjit të të drejtës së autorit.

Rekomandime:

- Kurrikula e programit mësimor "Mekatronikë" të ofrojë më shumë lëndë me zgjedhje si për formim në drejtimin e shkencave elektrike elektronike ashtu dhe për formimin në drejtimin e shkencave mekanike.
- Të shikohet mundësia e modifikimit të kurrikulës në pjesën A (Disiplina të formimit të përgjithshëm) dhe pjesën C (disiplina formuese të ngjashme) tek programi i lëndës së fizikës duke zvogëluar numrin e krediteve për arsyen se studentët marrin konceptet e fizikës dhe në lëndë të tjera si p.sh. Mekanika e Fluideve, Sistemet Pneumatike, etj.
- Lënda mësimore "Robotikë" rekomandohet të zhvillohet në fund, për arsye se sistemet robotikë janë sisteme komplekse dhe mund të quhet bashkim njohurish.
- Në lëndët me zgjedhje rekomandohet të vendosen lëndë me profil të ndryshëm, por për të njëjtin drejtim formimi (si p.sh. Kontroll elektromekanik ose Transmisione elektrike, etj.)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Dr. Ing. Thomaq KOBLARA
2. Dr. Alketa Grepcka



